



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 17 mars 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave që nuk janë Dëshmi
Gojore**

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Aleks Uajting

Mbrojtjes së të akuzuarit
Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

I.	HISTORIKU PROCEDURAL	2
II.	PARASHTRIME	3
III.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE	4
IV.	ANALIZË	4
A.	Parimi i përgjithshëm	5
B.	Vendimet mbi pranueshmërinë	11
1.	Rregullat përjashtuese.....	12
2.	Provat e mbledhura para themelimit të Dhomave të Specializuara	13
3.	Aktekspertizat	14
4.	Deklaratat me shkrim dhe transkriptet në vend të dëshmive gojore	14
C.	Procedura për paraqitjen e provave	18
1.	Udhëzime të përgjithshme	19
2.	Materiali i mbledhur para themelimit të Dhomave të Specializuara.....	22
3.	Materiali i paraqitur sipas rregullave 153-155 të Rregullores	23
4.	Materiale të tjera	24
5.	Paraqitja e materialit nëpërmjet dëshmitarit	25
6.	Lista përmbledhëse e materialeve të pranuar si prova	29
V.	VENDIM.....	29

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykues) lëshon këtë vendim mbi parashtrimin dhe pranueshmërinë e provave që nuk janë dëshmi gojore.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 30 shtator 2022, Trupi Gjykues kërkoi nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”), Mbrojtja e Pjetër Shalës (përkatësisht, “Mbrojtja” dhe “i akuzuari”) dhe Mbrojtësi i Viktimave, të dorëzonin parashtrime nëse Trupi Gjykues duhej të merrte vendim mbi pranueshmërinë e secilës provë (që nuk është dëshmi gojore) gjatë procesit gjyqësor, apo të vlerësonte pranueshmërinë e provave gjatë kuvendimeve në lidhje me vendimin mbi fajësinë ose pafajësinë e të akuzuarit.¹
2. Më 10 dhe 18 tetor 2022, përkatësisht Mbrojtja², Mbrojtësi i Viktimave³ dhe ZPS-ja,⁴ bënë parashtrimet e tyre.
3. Më 24 shkurt 2023, Trupi Gjykues lëshoi Vendimin mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit dhe Çështje të lidhura me To (“Vendimi mbi të Drejtat

¹ KSC-BC-2020-04, F00289, Trupi Gjykues I, *Vendim për Caktimin e Datave të Konferencave Përgatitore për Gjykimin dhe për Parashtrime nga Palët*, 30 shtator 2022, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, Pjesa III.C.6(d).

² KSC-BC-2020-04, F00305, Mbrojtja, *Parashtrime sipas Urdhrit për Mbajtjen e Konferencave Përgatitore për Gjykimin* (Parashtrimet e Mbrojtjes), 10 tetor 2022, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, para. 19. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po të njëjtën ditë, F00305/RED; Transkripti i seancës, 18 tetor 2022, publik, f. 382, rreshtat 13-20.

³ KSC-BC-2020-04, F00301, Mbrojtësi i Viktimave, *Parashtrime të Mbrojtësit të Viktimave për Konferencën Përgatitore për Gjykimin* (Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave), 10 tetor 2022, publike, para. 24.

⁴ KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 18 tetor 2022, publik, f. 380, rreshti 17 deri në f. 381, rreshti 25.

e Viktimave”)⁵ dhe Vendimin mbi Zhvillimin e Gjykimit (“Vendimi mbi Zhvillimin e Gjykimit”).⁶

II. PARASHTRIME

4. ZPS-ja parashtron se vendimi mbi pranueshmërinë e provave që nuk janë dëshmi gojore duhet të jepet kur ato të paraqiten dhe nuk duhet të lihet për në kohën e nxjerrjes së vendimit mbi fajësisë ose pafajësisë e të akuzuarit. Sidoqoftë, ZPS-ja nuk kundërshton praktikën dhe procedurën e zbatuar më parë nga Trupi Gjykses në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-05 (“Çështja 05”).⁷

5. Mbrojtja kundërshton shtyrjen prej Trupit Gjykses të marrjes së vendimit mbi pranueshmërinë e provave (që nuk janë dëshmi gojore) deri në përcaktimin e fajësisë ose pafajësisë së të akuzuarit në kuadër të aktgjykimit. Ajo parashtron se në një rast të tillë, palët nuk do të mund të njihen me kuadrin e provave të administruara nga Trupi Gjykses. Sipas Mbrojtjes: (a) pranueshmëria e provave që nuk janë dëshmi gojore të paraqitura përmes një dëshmitari në sallën e gjyqit duhet të përcaktohet në kohën e paraqitjes së tyre në gjykim, pasi palët të kenë pasur mundësinë të bëjnë vërejtje; dhe (b) çdo mocion lidhur me “provat jогоjore” duhet të kategorizohet sipas lëndës që trajtohet në to dhe të paraqitet pasi të jenë dëgjuar të gjithë dëshmitarët e thirrur nga pala përkatëse që dëshmojnë për një

⁵ KSC-BC-2020-04, F00433, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit dhe Çështje të lidhura me To*, 24 shkurt 2023, publik.

⁶ KSC-BC-2020-04, F00434/RED, Trupi Gjykses I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 24 shkurt 2023, publik.

⁷ KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 18 tetor 2022, publik, f. 381, rreshtat 20-25, që i referohen KSC-BC-2020-05, F00169, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave* (Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05), 25 gusht 2021, publik, ku Trupi Gjykses vendosi që, në përgjithësi, nuk do të vendoste paraprakisht gjatë gjykimit mbi pranueshmërinë e secilës provë - përveç në disa situata konkrete – dhe do të merrte parasysht kriteret standarde të pranueshmërisë së provave të paraqitura në kuadër të kuvendimeve në lidhje me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit.

temë të caktuar, në mënyrë që të vlerësohet si duhet konteksti dhe relevanca e provave të propozuara.⁸

6. Mbrojtësi i Viktimave nuk kundërshton zbatimin prej Trupit Gjykses të të njëjtës procedurë lidhur me parashtrimin dhe pranueshmërinë e provave si në Çështjen 05.⁹

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Trupi Gjykses mban parasysht nenet 37, 40(2) dhe 40(6)(h) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 99(4), 100, 137-139, 148(2), 149(4), dhe 153-155 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja").

IV. ANALIZË

8. Ky vendim ka lidhje me parashtrimin dhe pranueshmërinë e provave që nuk janë dëshmi gojore, të tilla si dokumente, videomateriale apo çfarëdolloj prove tjetër që nuk jepet gojarisht nga dëshmitari në sallën e gjyqit. Në këtë vendim, Trupi Gjykses jep udhëzime për palët dhe Mbrojtësin e Viktimave, sipas rastit, në lidhje me procedurën për paraqitjen e provave që nuk janë dëshmi gojore dhe qasjen e tij ndaj pranueshmërisë së provave të tilla, duke përcaktuar se në cilat rrethana konsiderohet se provat që nuk janë dëshmi gojore, janë në dispozicion të Trupit Gjykses në mënyrën e duhur për marrjen e vendimit mbi fajësinë ose pafajësinë e të akuzuarit.

⁸ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 19.

⁹ Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave, para. 24.

A. PARIMI I PËRGJITHSHËM

9. Sipas nenit 40(2) të Ligjit, pasi të ketë dëgjuar palët,¹⁰ Trupi Gjykses ka kompetencë diskrecionale për të organizuar zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të procesit, siç e shikon të arsyeshme. Konkretisht, neni 40(6)(h) i Ligjit i jep Trupit Gjykses kompetencë diskrecionale (“mund, kur është e nevojshme”) të nxjerrë vendim mbi pranueshmërinë e provave. Pavarësisht nga neni 37(1) të Ligjit, i cili përmban një përjashtim lidhur me kompetencën diskrecionale të Trupit Gjykses për të vendosur mbi pranueshmërinë e provave,¹¹ këto dispozita të Ligjit nuk e vënë Trupin Gjykses para detyrimit të marrjes së vendimit mbi pranueshmërinë si provë të çdo materiali të paraqitur në gjykim, as në momentin e paraqitjes, as në ndonjë fazë tjetër të procesit.¹²

10. I njëjti interpretim buron edhe nga Rregullorja, e cila është në përputhje me Ligjin.¹³ Rregulla 138(1) e Rregullores përcakton kriteret standarde të pranueshmërisë që duhet të zbatohet Trupi Gjykses kur vlerëson pranueshmërinë e provave (lidhja me lëndën, vërtetësia, vlera provuese dhe efekti dëmtues). Me rëndësi është që në këtë rregull gjithashtu përcaktohet se “në rast se nuk janë kundërshtuar ose përjashtuar *proprio motu*”, provat e paraqitura trupit gjykses duhet të pranohen në qoftë se përmbushen kriteret e përmendura më lart, pa e vënë trupin gjykses para detyrimit të marrjes së vendimit mbi pranueshmërinë si provë të çdo materiali që paraqitet. Në fakt, rregulla 138(1) e Rregullores shkon deri aty sa krijon prezumimin që provat e

¹⁰ Përmendja e fjalës “palë” në këtë vendim përfshin edhe Mbrojtësin e Viktimave, i cili mund të paraqesë prova, sikundër urdhërohet nga Trupi Gjykses, përveç nëse përcaktohet ndryshe. *Shih* Vendimi mbi të Drejtat e Viktimave, para. 37-46.

¹¹ *Shih në vijim* para. 27 më poshtë; *shih gjithashtu* Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 12.

¹² *Në mënyrë të ngjashme*, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 11-12.

¹³ Neni 19(3) i Ligjit. Në rast mospërputhjeje midis Ligjit dhe Rregullores, në bazë të rregullës 4(2) të Rregullores, përparësi ka Ligji.

paraqitura konsiderohen të pranuar, nëse përmbushen kriteret standarde të pranueshmërisë sipas rregullës 138(1). Rrjedhimisht, nga kjo dispozitë është e qartë se, përgjithësisht, Trupi Gjykses nuk është i detyruar të marrë vendim mbi pranueshmërinë si provë të çdo materiali të paraqitur në gjykim, as në momentin e paraqitjes, as në ndonjë fazë tjetër të procesit.¹⁴

11. Sidoqoftë, kjo varet nga kundërshtimi që paraqet një palë, ose nga kompetenca e përgjithshme e Trupit Gjykses për ta deklaruar *proprio motu* të papranueshëm si provë çfarëdo materiali që paraqitet, në përputhje me kriteret e përcaktuara në rregullën 138(1) të Rregullores, dhe pa cenuar zbatimin e rregullave specifike përjashtuese, siç do të shtjellohet më poshtë. Në këtë kontekst, vlen të nënvizohet se sipas rregullës 138(1) të Rregullores, kompetencat *proprio motu* të Trupit Gjykses, të cilat janë të përcaktuara qartësisht në nenin 40(6)(h) të Ligjit, nuk duhet të përdoren për të konfirmuar pranueshmërinë e një prove, por vetëm për të përjashtuar një provë nga dokumentacioni i provave, sipas rrethanave konkrete që paraqiten. Ky interpretim është në përputhje edhe me rregullat përjashtuese të përcaktuara në rregullat 138(2)-(3) dhe 148(2) të Rregullores, në të cilat përshkruhen situata konkrete në të cilat provat konsiderohen të papranueshme, duke i bërë në këto raste të detyrueshme vendimet mbi pranueshmërinë e tyre.¹⁵

12. Nga ana tjetër, rregulla 139 e Rregullores, ka të bëjë me *vlerësimin* nga Trupi Gjykses të provave në kuadër të aktgjykimit, d.m.th. pasi të ketë përfunduar paraqitja e provave. Në rregullën 139(1) të Rregullores përcaktohet se provat e shpallura të papranueshme nuk mund të merren parasysh nga Trupi Gjykses për aktgjykimin. Përkundrazi, provat që nuk janë përjashtuar konkretisht si të papranueshme mund të

¹⁴ Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 13.

¹⁵ Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 13.

merren parasysh nga Trupi Gjykses për përcaktimin e fajësisë ose pafajësisë së të akuzuarit.¹⁶ As nga rregulla 139 e Rregullores nuk rrjedh ndonjë detyrim për marrjen e vendimit mbi pranueshmërinë si provë të çdo materiali të paraqitur si të tillë.

13. Të gjitha dispozitat e përmendura më lart tregojnë se korniza ligjore e Dhomave të Specializuara nuk përcakton se Trupi Gjykses ka detyrimin e përgjithshëm të marrjes së vendimeve mbi pranueshmërinë si provë të çdo materiali të paraqitur në gjykim, përveç nëse Ligji dhe/ose Rregullorja udhëzojnë konkretisht Trupin Gjykses ta bëjë këtë, ose nëse Trupi Gjykses, në pajtim me kompetencën e vet *proprio motu* të përcaktuar në rregullën 138(1) të Rregullores, vlerëson se duhet të nxjerrë një vendim, siç shtjellohet në vijim më poshtë. Korniza ligjore gjithashtu nuk përcakton një të drejtë të përgjithshme dhe automatike të palëve për të marrë një vendim nga Trupi Gjykses mbi pranueshmërinë e çdo prove që ato paraqesin, as në momentin e paraqitjes së tyre, as në ndonjë fazë tjetër të procesit, përveç nëse parashihet ndryshe në kornizën ligjore të DHS-së.¹⁷

14. Sipas Trupit Gjykses, kriteret standarde të pranueshmërisë së provave të përcaktuara në rregullën 138(1), konkretisht, lidhja me lëndën dhe vlera provuese e provës, vlerësohen më saktë pasi të jenë marrë të gjitha provat e paraqitura në gjykim, duke pasur parasysh tërësinë e provave të administruara nga Trupi Gjykses.¹⁸ Kjo përputhet edhe me detyrimin që ka Trupi Gjykses në bazë të rregullës 139(2) të Rregullores, për të kryer një vlerësim dhe peshim tërësor të të gjitha provave në tërësi. Gjithashtu, kriteri i dhënies së një vendimi të arsyetuar u mundëson palëve të

¹⁶ Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 14.

¹⁷ Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 15.

¹⁸ Shih KSC-BC-2020-05, F00494/RED/COR, Trupi Gjykses I, *Version i Korrigjuar i Versionit të Redaktuar Publik të Aktgjykimit (Aktgjykimi Mustafa)*, 16 dhjetor 2022, publik, para. 32; Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 19.

verifikojnë saktësisht se si Trupi Gjykses i ka vlerësuar provat në të cilat është mbështetur dhe si i ka trajtuar kundërshtimet e ngritura, si dhe krijon sipas rastit mundësinë e rishqyrtimit në shkallën e apelit.¹⁹

15. Trupi Gjykses nuk është bindur nga argumenti i Mbrojtjes se ai duhet të vendosë mbi pranueshmërinë e provave që nuk janë dëshmi gojore gjatë gjykimit, ose përndryshe palët nuk do të kenë njohuri përpara parashtrimeve përmbyllëse për kuadrin e provave që do të merren parasysh nga Trupi Gjykses për aktgjykimin.²⁰

16. Së pari, në këtë vendim përcaktohet qasja e Trupit Gjykses ndaj parashtrimit dhe pranueshmërisë së provave, dhe informohen palët dhe Mbrojtësi i Viktimave për procedurën që duhet ndjekur gjatë gjithë procesit. Në kuadër të kuvendimeve të tij për përcaktimin e fajësisë ose pafajësisë së të akuzuarit, Trupi Gjykses do të marrë parasysh vetëm ato prova që janë përfshirë në mënyrën e duhur në dokumentacionin e provave sipas kësaj procedure. Me fjalë të tjera, në përfundim të procedurës së paraqitjes së provave,²¹ palët dhe Mbrojtësi i Viktimave do ta kenë plotësisht të qartë se cilat prova do të merren parasysh nga Trupi Gjykses në kuadër të aktgjykimit.

17. Së dyti, gjatë zhvillimit të gjykimit, Trupi Gjykses do të lëshojë vendime pas dorëzimit të (çdo pakete) të provave që nuk janë dëshmi gojore, duke i përfshirë ato sipas procedurës së duhur në dokumentacionin e çështjes gjyqësore. Provat do të përfshihen në dokumentacionin e çështjes gjyqësore kur: (a) pranohen, në rastet kur Trupi Gjykses është i detyruar të marrë vendim mbi pranueshmërinë e provave përpara zhvillimit të kuvendimeve mbi aktgjykimin, ose kur vendos ta bëjë këtë *proprio motu*, siç do të shpjegohet në vijim më poshtë; ose (b) konsiderohen se janë të dispozicion të Trupit Gjykses në kuadër të kuvendimeve në lidhje me vendimin mbi

¹⁹ Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 19.

²⁰ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 19.

²¹ Rregulla 134 e Rregullores.

fajësinë ose pafajësinë e të akuzuarit, kur Trupi Gjykes e shtyn vlerësimin e vet për kriteret standarde të pranueshmërisë së provave sipas rregullës 138(1) për kuvendimet mbi aktgjykimin, në përputhje me qasjen e përgjithshme të përcaktuar më sipër.

18. Pas vendimit/vendimeve të Trupit Gjykes, Njësia për Administrimin e Gjykatës (NJAGJ) do të regjistrojë secilën provë në sistemin elektronik *Legal Workflow* për këtë qëllim, duke i caktuar një numër regjistrimi që pasqyron statusin e saj. Nuk do të ketë paqartësi se cilat prova janë pjesë e dokumentacionit të provave dhe mund të merren parasysh nga Trupi Gjykes për aktgjykimin.

19. Së treti, Trupi Gjykes thekson se vetë Mbrojtja kërkon që provat që nuk janë dëshmi gojore e që nuk paraqiten përmes dëshmitarëve, të kategorizohen dhe paraqiten sipas lëndës së trajtuar në to, *pasi* të jenë dëgjuar të gjithë dëshmitarët e thirrur nga pala parashtruese, të cilët dëshmojnë për një lëndë të caktuar, në mënyrë që të vlerësohet si duhet pesha dhe konteksti i tyre.²² Në këtë mënyrë, Mbrojtja në fakt pranon se mund të mos jetë e mundur të vlerësohen si duhet kriteret standarde të pranueshmërisë së provave të përcaktuara në rregullën 138(1), konkretisht lidhja me lëndën dhe vlera provuese e tyre, përpara se pala parashtruese të ketë përfunduar paraqitjen e provave të saj. Në fakt, kjo përputhet me qëndrimin e përcaktuar nga Trupi Gjykes më lart. Për këto arsye, Trupi Gjykes rrëzon argumentin e Mbrojtjes.

20. Mbrojtja gjithashtu pretendon se vendimi mbi pranueshmërinë e provave që nuk janë dëshmi gojore duhet të merret në kohën e paraqitjes së tyre në gjykim, kur këto prova paraqiten përmes dëshmitarëve në sallën e gjyqit dhe pasi palët të kenë pasur mundësinë të bëjnë parashtrime.²³ Trupi Gjykes konfirmon se qasja e përgjithshme e vet e përcaktuar në këtë vendim, u mundëson palëve të parashtrojnë me shkrim dhe

²² Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 19.

²³ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 19.

gojarisht kundërshtime që kanë lidhje me provat që nuk janë dëshmi gojore, qoftë (i) gjatë apo pas dhënies së dëshmisë nga dëshmitari, kur këto prova paraqiten nëpërmjet një dëshmitari në sallën e gjyqit, ose (ii) në çdo fazë të procedurës së paraqitjes së provave, kur provat që nuk janë dëshmi gojore nuk paraqiten nëpërmjet një dëshmitari. Palët nuk ndalohen në asnjë moment që të paraqesin me shkrim ose gojarisht kundërshtime që kanë ndaj një prove gjatë gjykimit. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses sqaron se kundërshtimet e palëve që bazohen në rregullat përjashtuese do të trajtohen nga Trupi Gjykses drejtpërdrejt gjatë gjykimit; e njëjta vlen edhe nëse Trupi Gjykses konstaton se ka arsye bindëse për të vendosur mbi pranueshmërinë e një prove të caktuar gjatë gjykimit. Nga ana tjetër, çka palët nuk mund të presin të ndodhë është që Trupi Gjykses, pa pasur arsye bindëse, të marrë automatikisht vendim për çdo provë gjatë gjykimit si të ishte diçka e zakonshme, përfshirë edhe për kundërshtimet e përgjithshme në lidhje me kriteret standarde të pranueshmërisë të përcaktuara në rregullën 138(1); përkundrazi, diskutimi për këto kriteret do të bëhet në fund të procesit gjyqësor, pasi lidhja me lëndën dhe vlera provuese e çdo prove vlerësohet më saktë duke mbajtur parasysh tërësinë e provave të paraqitura para Trupit Gjykses në gjykim.²⁴

21. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses, në përgjithësi, nuk do të japë vendime mbi pranueshmërinë si provë të çdo materiali pas paraqitjes së tij gjatë gjykimit, përveç nëse: (i) provat kundërshtohen dhe Trupi Gjykses konstaton se ka arsye bindëse për të vendosur mbi pranueshmërinë e një prove të caktuar; (ii) Trupi Gjykses ushtron *proprio motu* kompetencën e tij për të vendosur, në kuadër të marrjes së vendimit për pranueshmërinë e provave të caktuara, për përjashtimin e ndonjëres prej tyre; ose (iii) Trupi Gjykses detyrohet nga dispozita konkrete ligjore ta bëjë këtë, siç shtjellohet në vijim më poshtë. Gjatë kuvendimeve në lidhje me aktgjykimin, Trupi Gjykses do

²⁴ Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 19.

të marrë parasysh kriteret standarde të pranueshmërisë së provave të përcaktuara në rregullën 138(1) të Rregullores, në kuadër të vlerësimit të provave gjatë përcaktimit të fajësisë ose pafajësisë së të akuzuarit si dhe mbi bazën e një vlerësimi tërësor të të gjitha materialeve që janë pjesë e provave të kësaj çështjeje gjyqësore,²⁵ ndonëse jo domosdoshmërisht mund të shtjellojë aspekte të tilla për çdo provë në aktgjykim.²⁶ Sidoqoftë, Trupi Gjykes tani do të vijojë me shpjegimin se në cilat rrethana jepen vendime më vete mbi pranueshmërinë.²⁷

B. VENDIMET MBI PRANUESHMËRINË

22. Pavarësisht prej qasjes së përgjithshme të Trupit Gjykes për ta shtyrë për në fazën e aktgjykimit shqyrtimin e kriterëve standarde të rregullës 138(1) mbi pranueshmërinë e secilës prove, Trupit Gjykes i duhet të marrë vendime mbi pranueshmërinë e provave rast për rast, përpara se të bëjë vlerësimin e provave në kuadër të aktgjykimit, kur: (i) zbatohen rregulla konkrete përjashtuese (Pjesa B.1); (ii) Ligji ose Rregullorja detyrojnë Trupin Gjykes të marrë vendim mbi pranueshmërinë e provave të caktuara (Pjesët B.2-3); ose (iii) zbatohen dispozita që vendosin disa parakushte ose kriterë procedurale për paraqitjen e provave (Pjesa B.4). Sipas rregullës 139(1) të Rregullores, provat e shpallura të papranueshme nuk merren parasysh nga Trupi Gjykes në kuadër të aktgjykimit.²⁸

²⁵ Rregullat 137(2) dhe 139(2) të Rregullores.

²⁶ KSC-CA-2022-01, F00114, Gjykata e Apelit, *Aktgjykimi i Apelit*, 2 shkurt 2023, para. 33, me referenca të mëtejshme nga jurisprudenca.

²⁷ *Në mënyrë të ngjashme*, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 21.

²⁸ *Në mënyrë të ngjashme*, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 22.

1. Rregullat përjashtuese

23. Rregullat 138(2)-(3) dhe 148(2) të Rregullores (të ashtuquajturat rregulla përjashtuese) përshkruajnë situata konkrete në të cilat provat konsiderohen të papranueshme. Siç përcaktohet në rregullën 139(1) të Rregullores, provat e shpallura të papranueshme nuk merren parasysh nga Trupi Gjykses në kuadër të aktgjykimit.²⁹ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses, para diskutimeve mbi fajësinë ose pafajësinë e të akuzuarit, duhet të sigurojë që provat e paraqitura në gjykim të mos jenë të papranueshme për shkak të një rregulle përjashtuese.³⁰

24. Rregulla 138(2) e Rregullores parashikon përjashtimin e provave të siguruara nëpërmjet një shkeljeje të Ligjit ose të Rregullores apo të normave të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Gjatë kryerjes së vlerësimit sipas rregullës 138(2) të Rregullores, Trupi Gjykses zbaton një standard që ka dy elemente: Së pari, provat duhet të jenë siguruar nëpërmjet një shkeljeje të Ligjit ose të Rregullores, ose të normave të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Vetëm nëse vërtetohet një shkelje e tillë, Trupi Gjykses vijon me shqyrtimin e dy kushteve alternative: (i) shkelja krijon dyshim të konsiderueshëm në mbështetshmërinë në atë provë; ose (ii) pranimi i provës do të ishte shkelje, ose do të dëmtonte rëndë integritetin e procesit.³¹

25. Rregulla 138(3) e Rregullores përmban një tjetër rregull përjashtuese sipas të cilës provat e siguruara me anë të torturës, apo të çfarëdo forme të trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës, janë të papranueshme dhe përjashtohen.

²⁹ Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 21-22.

³⁰ Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 13.

³¹ Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 25; KSC-BC-2020-04, F00364/COR/RED, Trupi Gjykses I, *Version i Redaktuar Publik i Versionit të Korrigjuar të Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala* (Vendimi në lidhje me Deklaratat e të Akuzuarit), 6 dhjetor 2022 (version i redaktuar publik u nxor më 26 janar 2023), publik, para. 18-19.

26. Së fundi, rregulla 148(2) e Rregullores përcakton se në rastet kur ngrihen pretendime për dhunë seksuale, sjellja seksuale e mëhershme ose e mëpasshme e viktimës nuk pranohet si provë.

2. Provat e mbledhura para themelimit të Dhomave të Specializuara

27. Neni 37(1) i Ligjit përcakton se pranueshmëria e provave të mbledhura gjatë procedurave ose hetimeve penale brenda juridiksionit lëndor të Dhomave të Specializuara para themelimit të tyre “vendoset” nga Trupi Gjykses në pajtim me standardet ndërkombëtare për mbledhjen e provave dhe nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Neni 37(1) i Ligjit parashikon një përjashtim nga kompetenca diskrecionale e Trupit Gjykses që përcaktohet në nenin 40(6)(h) të Ligjit. Ky nen udhëzon Trupin Gjykses të marrë vendime rast për rast mbi pranueshmërinë e provave të mbledhura para themelimit të Dhomave të Specializuara, ku përfshihen provat e mbledhura nga cildo autoritet ose agjenci shtetërore ose ndërkombëtare ligjzbatuese ose për kryerjen e hetimeve penale, përfshirë Prokurorin e Shtetit të Kosovës, autoritetet policore të Kosovës, Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, Misionin e Sundimit të Ligjit të BE-së në Kosovë ose Task Forcën Hetimore Speciale.³²

28. Neni 37(3) i Ligjit përcakton lloje të caktuara të provave që *mund* të konsiderohen si të pranueshme nga Trupi Gjykses, nëse plotësohen disa kushte, në varësi të marrjes së një vendimi gjyqësor për pranueshmërinë e tyre, sipas nenit 37(1) të Ligjit.

³² Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 12, 23. *Shih gjithashtu*, Vendimin në lidhje me Deklaratat e të Akuzuarit, para. 18.

3. Aktekspertizat

29. Rregulla 149(4) e Rregullores përcakton se, në qoftë se plotësohen disa parakushte, sikurse përcaktohet në rregullën 149(2)(b) dhe (c) të Rregullores, Trupi Gjykses vendos mbi pranueshmërinë e aktekspertizës së dëshmitarit ekspert pas dëshmisë dhe përgjigjeve të dhëna nga eksperti për pyetjet e bëra.³³

4. Deklaratat me shkrim dhe transkriptet në vend të dëshmime gojore

30. Në fjalinë e parë të rregullës 141(1) të Rregullores mishërohet parimi i paraqitjes së dëshmime gojore, sipas të cilit dëshmitarët e japin dëshminë e tyre në gjyq duke qenë të pranishëm, përveç nëse parashikohet ndryshe. Kjo do të thotë se dëshmitarët duhet të paraqiten në sallën e gjyqit personalisht dhe të japin dëshminë e tyre gojarisht. Rëndësia e dhënies së dëshmisë duke qenë të pranishëm në sallën e gjyqit qëndron në faktin se dëshmitari e jep dëshminë nën betim dhe nën vëzhgimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të Trupit Gjykses.³⁴ Kjo mundëson që dëshmia që jep dëshmitari të verifikohet plotësisht përmes pyetjeve që i drejtohen, ku Trupi Gjykses është në gjendje të vlerësojë saktësinë dhe mbështetshmërinë në atë dëshmi. Sidoqoftë, dhënia e dëshmisë me prani të dëshmitarit në sallën e gjyqit nuk është mënyra e vetme për marrjen e dëshmisë së dëshmitarit nga Trupi Gjykses.

31. Rregulla 100(1) e Rregullores lejon marrjen e deponimeve me vendim të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, të cilat mund të përdoren në gjykim pa qenë nevoja që personi ta japë dëshminë gojarisht para Trupit Gjykses. Prova të tilla ruhen

³³ Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 24. *Shih gjithashtu*, Vendimin mbi Zhvillimin e Gjykimit, para. 59, 62.

³⁴ Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 27. *Shih gjithashtu*, ICC, *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-1386, Appeals Chamber, [Judgment on the appeals of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo and the Prosecutor against the decision of Trial Chamber III entitled "Decision on the admission into evidence of materials contained in the prosecution's list of evidence"](#), 3 May 2011, public, para. 76.

nën mbikëqyrjen e Gjykatësit të Procedurës Paraprake duke respektuar plotësisht të drejtat e palës kundërshtare.³⁵ Pas kalimit të dosjes së çështjes gjyqësore Trupit Gjykses, pranueshmëria e materialeve të rregullës 100 trajtohet nga rregulla 138 e Rregullores, siç sqarohet në rregullën 99(4) të Rregullores.³⁶

32. Rregullat 153-155 të Rregullores janë instrumente për të përshpejtuar dhe thjeshtuar procesin.³⁷ Ato lejojnë paraqitjen e deklaratave me shkrim ose transkripteve që zëvendësojnë ose plotësojnë dëshminë gojore të një dëshmitari, me kusht që të plotësohen disa parakushte ose kritere procedurale.³⁸ Rregullat 153 dhe 155 të Rregullores lejojnë paraqitjen e deklaratave/transkripteve të dëshmitarëve që nuk janë të pranishëm para Trupit Gjykses. Rregulla 154 e Rregullores lejon paraqitjen e deklaratave/transkripteve të dëshmitarëve që janë të pranishëm para Trupit Gjykses. Rrjedhimisht, rregullat 153 dhe 155 të Rregullores janë përjashtime të plota nga parimi i paraqitjes së dëshmive gojore, ndërsa rregulla 154 e Rregullores vetëm e kufizon këtë parim. Provat që merren prej dëshmitarëve janë të papranueshme kur nuk sigurohen gojarisht ose kur nuk përmbushen parakushtet për paraqitjen e deklaratave me shkrim/transkripteve sipas rregullave 153-155 të Rregullores.³⁹

³⁵ *Shih*, në veçanti, rregullën 100(3)-(5) të Rregullores.

³⁶ *Në mënyrë të ngjashme*, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 28.

³⁷ *Në mënyrë të ngjashme*, ICC, *Prosecutor v. Yekatom and Ngaïssona*, ICC-01/14-01/18-685, [Decision on the Prosecution Extension Request and Initial Guidance on Rule 68 of the Rules](#) (Yekatom Initial Rule 68 Guidance), 16 October 2020, public, para. 26.

³⁸ Trupi Gjykses vëren se termat “deklaratë me shkrim” dhe “transkript” përfshijnë edhe shtojcat ose dokumentet e tjera që lidhen deklaratën me shkrim/transkriptin, të cilat përdoren ose për të cilat jep shpjegime dëshmitari dhe të cilat, si të tilla, janë pjesë përbërëse e vetë dëshmisë; *shih* Vendimin mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, poshtëshënimi 27. *Shih për ngjashmëri*, ICC, *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-596-Red, Trial Chamber IX, [Decision on the Prosecution's Applications for Introduction of Prior Recorded testimony under Rule 68\(2\)\(b\) of the Rules](#), 18 November 2016, public, para. 10. Kjo nuk cenon kompetencën diskrecionale të Trupit Gjykses për të vendosur se disa shtojca ose dokumente të tjera që kanë lidhje me deklaratën me shkrim/transkriptin janë të papranueshme.

³⁹ *Në mënyrë të ngjashme*, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 29. *Shih gjithashtu*, ICC, *Prosecutor v Bemba et al*, ICC-01/05-01/13-2275-Red, Appeals Chamber,

33. Më konkretisht, rregulla 153 e Rregullores i jep kompetenca diskrecionale Trupit Gjykses për të pranuar, në vend të dëshmisë gojore, deklaratën me shkrim të një dëshmitari, ose transkriptin e dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar në proces gjyqësor para DHS-së, që është për vërtetimin e një aspekti dhe jo për veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit për të cilat akuzohet në aktakuzë. Gjatë marrjes së vendimeve mbi pranueshmërinë e këtyre provave, Trupi Gjykses orientohet prej një grupi faktorësh joshterues të përcaktuar në rregullën 153(2) dhe (3) të Rregullores, që peshojnë në favor ose kundër pranimit të tyre. Gjithashtu, rregulla 153(2) e Rregullores përmban kushte procedurale që synojnë forcimin e vlerës provuese të materialit të paraqitur sipas rregullës 153 të Rregullores.⁴⁰

34. Rregulla 154 e Rregullores i jep kompetenca diskrecionale Trupit Gjykses për të pranuar deklaratën me shkrim të një dëshmitari, ose transkriptin me shkrim të dëshmisë së një dëshmitari të dhënë në proces gjyqësor para Dhomave të Specializuara që është për vërtetimin e veprimeve dhe sjelljes së të akuzuarit sipas akuzave që përmban aktakuza, në qoftë se përmbushen kushtet e mëposhtme: (i) dëshmitari është i pranishëm në sallën e gjyqit (ii) dëshmitari është në dispozicion për pyetje nga pala kundërshtarë dhe nga Trupi Gjykses; dhe (iii) dëshmitari konfirmon se deklarata me shkrim ose transkripti pasqyron saktësisht çfarë ka thënë dhe çfarë do të thoshte po të merrej në pyetje. Deklarata/transkripti me shkrim e/i pranuar plotëson dëshminë gojore të dëshmitarit. Pala jothirrëse ka mundësinë të verifikojë të gjithë dëshminë e dëshmitarit, si në lidhje me dëshminë në gjyq ashtu edhe

[Judgment on the appeals of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo, Mr Aimé Kilolo Musamba, Mr Jean-Jacques Mangenda Kabongo, Mr Fidèle Babala and Mr Narcisse Arido against the Decision of Trial Chamber VII entitled "Judgment pursuant to Article 74 of the Statute", 8 March 2018, public, para. 581; Prosecutor v. Yekatom and Ngaïssona, ICC-01/14-01/18-631, Trial Chamber V, \[Initial Directions on the Conduct of Proceedings\]\(#\) \(Yekatom Initial Directions\), 26 August 2020, public, para. 56.](#)

⁴⁰ Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 30.

deklaratën/transkriptin me shkrim.⁴¹ Me kërkesë të palës thirrëse, Trupi Gjykses nxjerr vendime para dhënies së dëshmisë përkatëse në sallën e gjyqit. Sidoqoftë, në parim, Trupi Gjykses e bën vlerësimin e vet përfundimtar kur dëshmitari paraqitet para Trupit Gjykses dhe konfirmon saktësinë e deklaratës së tij/saj të mëparshme që kërkohet të paraqitet.⁴²

35. Së fundi, rregulla 155(1) e Rregullores i jep kompetenca diskrecionale Trupit Gjykses për të pranuar dëshmi në formën e deklaratave me shkrim, të dokumenteve të tjera me shkrim, ose të shprehura ndryshe, të thënieve të një personi, apo transkriptin e deklaratës së një personi i cili ka vdekur, ose që nuk mund të gjendet duke vepruar me zell të arsyeshëm, apo i cili për shkak të dëmtimeve fizike apo mendore, ose për arsye të tjera bindëse, nuk është në gjendje të dëshmojë gojarisht, në qoftë se Trupi Gjykses bindet se: (i) personi është i padisponueshëm, ose i paafte për të dëshmuar gojarisht; dhe (b) deklarata, incizimi ose transkripti është *prima facie* i besueshëm, duke marrë parasysh rrethanat në cilat është bërë, incizuar dhe ruajtur. Rregulla 155(2) e Rregullores lejon pranimin e dëshmisë në formën e deklaratës me shkrim, të çdo incizimi, apo transkripti *prima facie* të besueshëm të deklaratës së një personi, në qoftë se Trupi Gjykses bindet se: (i) personi nuk është paraqitur në gjyq si dëshmitar, ose megjithëse ka qenë i pranishëm si dëshmitar, nuk ka dëshmuar aspak, ose nuk ka dëshmuar në lidhje me një pikë juridikisht thelbësore; (ii) mungesa e personit ose mosdhënia e dëshmisë është ndikuar thelbësisht nga ndërhyrje të palejueshme, ndër të cilat kërcënim, frikësim, lëndim, ofrim parash, ose shtrëngim, siç përshkruhet më tej në rregullën 155(3)(a) të Rregullores; (iii) në varësi të rrethanave, janë bërë përpjekje të arsyeshme sipas rregullës 100 dhe rregullës 121 të Rregullores për të siguruar praninë e personit si dëshmitar, ose në qoftë se ka qenë i pranishëm,

⁴¹ Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 31. Shih gjithashtu, [Yekatom Initial Rule 68 Guidance](#), para. 30.

⁴² Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 31. Shih gjithashtu, ICC, [Yekatom Initial Directions](#), para. 58.

janë bërë përpjekje të arsyeshme që nga dëshmitari të merren të gjitha faktet thelbësore për të cilat dëshmitari ka dijeni; (iv) dëshmia e propozuar ose dëshmia në lidhje me të njëjtën gjë nuk mund të merret ndryshe; dhe (v) është në interes të drejtësisë, sikundër përshkruhet më tej në rregullën 155(3)(b) të Rregullores.⁴³

36. Në parim, i takon palës thirrëse të vendosë nëse do të përdorë apo jo modalitetet e mësipërme. Sidoqoftë, kjo përzgjedhje i nënshtrohet kontrollit gjyqësor. Konkretisht, Trupi Gjyqësor ndërhyn në përzgjedhjen prej palës thirrëse lidhur me paraqitjen e provave të saj, kur lind mundësia e cenimit të të drejtave të të akuzuarit⁴⁴ – konkretisht të së drejtës për t'u përballur dhe për të pyetur në sallën e gjyqit një person që ngre pretendime kundër tij ose saj - dhe për të siguruar kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit,⁴⁵ në respekt të plotë të parimit të paraqitjes së dëshmimeve gojore dhe seancave publike.⁴⁶ Së fundi, vendimi sipas rregullave 153-155 të Rregullores merret rast pas rasti, duke marrë parasysh rrethanat konkrete të çështjes.⁴⁷

C. PROCEDURA PËR PARAQITJEN E PROVAVE

37. Trupi Gjyqësor përdor procedurën e mëposhtme për paraqitjen e provave, e cila zbatohet në mënyrë të njëjtë për ZPS-në dhe Mbrojtjen. E njëjta procedurë zbatohet *mutatis mutandis* edhe për Mbrojtësin e Viktimave, i cili mund të paraqesë prova në përputhje me Vendimin mbi të Drejtat e Viktimave.⁴⁸ Duke pasur parasysh pamundësinë e Mbrojtjes dhe Mbrojtësit të Viktimave në këtë fazë për të dhënë

⁴³ Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 32.

⁴⁴ Neni 21(4)(c), (d) dhe (f) i Ligjit; Rregulla 138(1) e Rregullores.

⁴⁵ Neni 40(2) i Ligjit.

⁴⁶ Neni 21(2) i Ligjit.

⁴⁷ Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 33.

⁴⁸ Vendimi mbi të Drejtat e Viktimave, para. 37-46.

informacion të saktë lidhur me provat që ata do të paraqesin eventualisht,⁴⁹ më vonë gjatë procesit mund të përcaktohen afate të mëtejshme konkrete.

1. Udhëzime të përgjithshme

38. Fillimisht, Trupi Gjykes nënvizon se palët mbajnë përgjegjësi të plotë për përzgjedhjen dhe paraqitjen e provave në mbështetje të argumenteve të tyre. Çka është më e rëndësishme, është detyrë e tyre të sigurojnë që çdo provë që ato paraqesin të përmbushë kriteret standarde të pranueshmërisë të përcaktuara në rregullën 138(1). Palët janë gjithashtu përgjegjëse për dhënien e argumenteve të mëtejshme për pranueshmërinë e provave nëse lindin pyetje ose shqetësime gjatë gjykimit. Ndërhyrja e Trupit Gjykes parashikohet vetëm nëse duhet të zgjidhen mosmarrëveshje ose nëse në bazë të dispozitave ligjore konkrete Trupi Gjykes duhet të nxjerrë vendim mbi pranueshmërinë e provave, siç është përcaktuar më lart. Përveç këtyre rasteve, nuk është përgjegjësi e Trupit Gjykes të udhëzojë dhe këshillojë paraprakisht palët dhe të marrë vendime paraprake mbi pranueshmërinë e provave individuale para se të jenë dëgjuar në tërësi dëshmitë.⁵⁰

39. Gjithashtu, palëve u rikujtohet se duhet të jenë përzgjedhëse në kërkesat e tyre për pranimin e provave, për të bërë të mundur që gjykimi të përfundojë brenda një kohe të arsyeshme.⁵¹ Ato gjithashtu duhet të mos kërkojnë të paraqesin materiale të cilat tashmë janë paraqitur me kërkesat e mëparshme dhe/ose janë pranuar ose konsiderohet se janë në dispozicion të Trupit Gjykes për kuvendimet dhe aktgjykimin.

⁴⁹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 15-17; Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave, para. 17-19.

⁵⁰ *Në mënyrë të ngjashme*, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 18.

⁵¹ *Në mënyrë të ngjashme*, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 34.

40. Çka është e rëndësishme, Trupi Gjykses u rikujton palëve se materiali në fjalë duhet t'i jetë nxjerrë palës kundërshtare, Mbrojtësit të Viktimave dhe Trupit Gjykses.⁵² Në vijim, Trupi Gjykses ofron udhëzime të përgjithshme që kanë të bëjnë me të gjitha llojet e provave që nuk janë dëshmi gojore, qofshin ato të paraqitura përmes një dëshmitari apo jo.

41. *Materialet e gjata.* Si rregull i përgjithshëm, materialet, edhe nëse janë të gjata, paraqiten për pranim në tërësinë e tyre, në mënyrë që Trupi Gjykses të ketë mundësi të vlerësojë kuptimin e saktë dhe kontekstin më të gjerë të pjesës ose pjesëve të materialit në të cilat mbështeten palët. Në rast se Trupi Gjykses synon të mbështetet në pjesë të tjera të materialit nga ato të propozuara nga palët, ai i njofton palët për këtë.⁵³ Sidoqoftë, Trupi Gjykses ruan diskrecionin për të pranuar/konsideruar se ka në dispozicion për kuvendimet dhe aktgjykimin vetëm pjesë të materialit, kur sasia ose lloji konkret i provave përlligj një qasje të tillë. Pala që paraqet provën udhëzohet të bëjë të ditur nëse kërkon që materiali në fjalë të pranohet vetëm pjesërisht.⁵⁴

42. *Përkthimet dhe/ose transkriptet.* Kur bëjnë kërkesë për pranimin e materialit në një gjuhë që nuk është anglishtja,⁵⁵ edhe në lidhje me audiomaterialet dhe videomaterialet, palët e paraqesin materialin origjinal së bashku me përkthimin/përkthimet dhe/ose transkriptin/transkriptet shoqëruese. Në qoftë se

⁵² Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 34.

⁵³ Për ngjashmëri, ICC, *Prosecutor v. Gbagbo and Blé Goudé*, ICC-02/11-01/15-498-AnxA, Trial Chamber I, [Annex A to Decision adopting amended and supplemented directions on the conduct of the proceedings](#), 4 May 2016, public, para. 47.

⁵⁴ Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 38, 47; KSC-BC-2020-05, F00285/RED, Trupi Gjykses I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Materialet e Përdorura me Dëshmitarët W03593, W04600, W01679 dhe W03594 gjatë Dhënies së Dëshmive të Tyre në Sallën e Gjyqit* (Vendimi i 17 Dhjetorit 2021 në Çështjen 05), 17 dhjetor 2021, publik, para. 15.

⁵⁵ KSC-BC-2020-04, F00025, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Gjuhën e Punës*, 21 prill 2021, publik; F000289, Trupi Gjykses I, *Vendim për Caktimin e Datave të Konferencave Përgatitore për Gjykimin dhe për Parashtrime nga Palët*, 30 shtator 2022, publik, para. 7.

përkthimi/përkthimet ose transkripti/transkriptet nuk ekzistojnë, palët e bëjnë këtë gjë të ditur në kërkesat e tyre. Vendimi për pranimin e këtyre materialeve, përfshirë audiomaterialet dhe videomaterialet, ose për t'i konsideruar se janë në dispozicion të Trupit Gjykes për kuvendimet dhe aktgjykimin, përfshin automatikisht edhe të gjitha përkthimet dhe transkriptet shoqëruese të tyre, që janë nxjerrë në mënyrën e duhur dhe anasjelltas. NJAGJ-ja siguron që statusi i materialit të pasqyrohet në mënyrë të saktë në sistemin elektronik *Legal Workflow* për të gjitha versionet në fjalë, d.m.th. për versionin original, përkthimin/përkthimet dhe transkriptin/transkriptet.⁵⁶

43. *Versionet e paredaktuara/me më pak redakte.* Vendimi për pranimin e një materiali ose për të konsideruar se është në dispozicion të Trupit Gjykes për kuvendimet dhe aktgjykimin, përfshin automatikisht edhe çdo version të mëvonshëm të paredaktuar ose me më pak redakte, në varësi të kundërshtimeve të mundshme nga palët. Për dokumentimin e saktë të procesit, në rast të nxjerrjes në të ardhmen të ndonjë versioni të paredaktuar apo me më pak redakte të këtyre materialeve, pala nxjerrëse e informon menjëherë palën tjetër, Mbrojtësin e Viktimave, Trupin Gjykes dhe Zyrën Administrative (NJAGJ-në). Kjo i mundëson NJAGJ-së që në sistemin *Legal Workflow* të lidhë çdo version të mëvonshëm të paredaktuar apo me më pak redakte me versionin e pranuar ose që konsiderohet pjesë e provave për kuvendimet dhe aktgjykimin e Trupit Gjykes. Në rast se pala tjetër ose Mbrojtësi i Viktimave kanë kundërshtime lidhur me versione të tilla të mëvonshme të paredaktuara apo me më pak redakte, ata njoftojnë Trupin Gjykes për këtë brenda pesë ditësh nga njoftimi i nxjerrjes së tyre.⁵⁷

⁵⁶ Kjo bëhet pavarësisht nëse palët i kanë përfshirë përkthimin/përkthimet ose transkriptin/transkriptet në kërkesat e tyre, për sa kohë që përkthimi/përkthimet ose transkripti/transkriptet janë nxjerrë në mënyrën e duhur. *Në mënyrë të ngjashme*, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 37, 47.

⁵⁷ *Në mënyrë të ngjashme*, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 37, 47; KSC-BC-2020-05, F00281/RED, Trupi Gjykes I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi*

2. Materiali i mbledhur para themelimit të Dhomave të Specializuara

44. Trupi Gjykses ka marrë shënim mocionin e ZPS-së për pranimin e provave dokumentare, përfshirë të ashtuquajturin material të nenit 37.⁵⁸ Trupi Gjykses udhëzon ZPS-në që, nëse dëshiron, të dorëzojë kërkesat e tjera që ka për pranimin e materialeve sipas nenit 37 të Ligjit, jo më vonë se të **premtën, 14 prill 2023**. Afatet përkatëse për Mbrojtjen dhe Mbrojtësin e Viktimave do të caktohen më vonë gjatë procesit.

45. Kur bëjnë kërkesë për pranimin e materialit sipas nenit 37 të Ligjit, palët: (i) përshkruajnë shkurtimisht lidhjen e pretenduar të secilit prej materialeve me akuzat faktike për të cilat bëhet fjalë; (ii) tregojnë vlerën provuese të pretenduar të secilit prej materialeve; dhe (iii) japin informacion lidhur me vërtetësinë e secilit material, nëse e disponojnë.⁵⁹

46. Pas marrjes së kërkesës, pala kundërshtarë mund të përgjigjet dhe të paraqesë kundërshtime me shkrim dhe/ose me gojë ndaj provave konkrete, nëse ka.⁶⁰ Mbrojtësi i Viktimave mund të bëjë parashtrime në këtë aspekt, nëse ka, në pajtim me Vendimin mbi të Drejtat e Viktimave.⁶¹ Më pas, Trupi Gjykses do të vazhdojë me marrjen e

Pranimin e Provave të Mbledhura para Themelimit të Dhomave të Specializuara dhe Materialeve të Tjera, 13 dhjetor 2021, publik, para. 25.

⁵⁸ KSC-BC-2020-04, F00431, Prokurori i Specializuar, *Mocion i Prokurorisë për Pranimin e Provave Dokumentare*, 22 shkurt 2023, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 2 mars 2023, F00431/RED; F00447, Mbrojtja, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Provave Dokumentare*, 6 mars 2023, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 9 mars 2023, F00447/RED; F00453, Prokurori i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj Përgjigjes së Mbrojtjes ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Provave Dokumentare*, 10 mars 2023, konfidenciale.

⁵⁹ Kur është e përshtatshme, informacioni në pikat (i)-(iii) mund të përmblihet për grupe dokumentesh. *Në mënyrë të ngjashme*, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 35.

⁶⁰ *Shih* Rregullat 76 dhe 138(1), fjalia e dytë, të Rregullores. *Në mënyrë të ngjashme*, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 36.

⁶¹ *Shih* Rregullën 76 të Rregullores; Vendimi mbi të Drejtat e Viktimave, para. 50.

vendimit mbi pranueshmërinë e materialit në fjalë, sikundër parashihet në nenin 37 të Ligjit dhe rregullën 138 të Rregullores.⁶²

47. Duke mbajtur parasysh parimin e paraqitjes së dëshmime gojore, neni 37 i Ligjit nuk zbatohet për deklaratat ose materialet që kanë të bëjnë me dëshmitarët që thirren për të dëshmuar para Trupit Gjykses.⁶³

3. Materiali i paraqitur sipas rregullave 153-155 të Rregullores

48. Trupi Gjykses rikujton afatet e përcaktuara në Vendimin mbi Zhvillimin e Gjykimit për ZPS-në, Mbrojtjen dhe Mbrojtësin e Viktimave për dorëzimin e kërkesave sipas rregullave 153, 154 dhe 155(1) të Rregullores.⁶⁴ Përgjithësisht, pas marrjes së këtyre kërkesave, pala kundërshtare mund të përgjigjet dhe të paraqesë kundërshtimet e saj, nëse ka. Mbrojtësi i Viktimave mund të përgjigjet dhe të paraqesë parashtrimet e tij në këtë aspekt, nëse ka, në pajtim me Vendimin mbi të Drejtat e Viktimave.⁶⁵ Përveç nëse urdhërohet ndryshe, dorëzimi i përgjigjeve dhe, nëse është e nevojshme, i kundërpërgjigjeve, bëhet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores.

49. Pas marrjes së të gjitha parashtrimeve të kërkuara, Trupi Gjykses: (i) në lidhje me kërkesat sipas rregullave 153 dhe 155(1) të Rregullores, do të vendosë mbi pranueshmërinë e deklaratës/deklaratave ose transkriptit/transkripteve; dhe (ii) në lidhje me kërkesat sipas rregullës 154 të Rregullores, do të vendosë paraprakisht mbi

⁶² Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 36.

⁶³ Në mënyrë të ngjashme, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 39.

⁶⁴ Vendimi mbi Zhvillimin e Gjykimit, para. 67-69. Trupi Gjykses rikujton afatin e caktuar për dorëzimin e përgjigjeve nga Mbrojtja dhe Mbrojtësi i Viktimave dhe për paraqitjen e kundërshtimeve ndaj kërkesës së ZPS-së, si dhe afatin për dorëzimin e kundërpërgjigjes nga ZPS-ja, *shih* Vendimin mbi Zhvillimin e Gjykimit, para. 67.

⁶⁵ Vendimi mbi të Drejtat e Viktimave, para. 50.

pranueshmërinë e deklaratës/deklaratave ose transkriptit/transkripteve, në pritje të konfirmimit të dëshmitarit në sallën e gjyqit.⁶⁶

50. Sa u përket kërkesave sipas rregullës 155(2) të Rregullores, Trupi Gjykses udhëzon palët që t'i bëjnë këto kërkesa sa më shpejt të jetë e mundshme. Pas marrjes së të gjitha parashtrimeve, Trupi Gjykses do të vijojë me marrjen e vendimit mbi pranueshmërinë e deklaratës/deklaratave ose transkriptit/transkripteve në fjalë.⁶⁷

4. Materiale të tjera

51. Trupi Gjykses ka marrë shënim mocionin e ZPS-së për pranimin e provave dokumentare që nuk janë dëshmi gojore,⁶⁸ dhe urdhëron ZPS-në që, nëse dëshiron, të dorëzojë çdo kërkesë tjetër që ka për pranimin e materialeve që nuk përfshihen në kategoritë e lartpërmendura, jo më vonë se të **premtën, 14 prill 2023**. Afatet përkatëse për Mbrojtjen dhe Mbrojtësin e Viktimave do të caktohen më vonë gjatë procesit.

52. Në kërkesë, palët dhe Mbrojtësi i Viktimave urdhërohen: (i) të përshkruajnë shkurtimisht lidhjen e pretenduar të secilit material me pretendimin faktik në fjalë; (ii) të tregojnë vlerën provuese të pretenduar të secilit prej materialeve; dhe (iii) të japin informacion mbi vërtetësinë e çdo materiali, nëse e disponojnë.⁶⁹

53. Pas marrjes së kërkesës, pala kundërshtare mund të përgjigjet dhe të paraqesë me shkrim dhe/ose gojarisht kundërshtimet ndaj provave konkrete, nëse ka.⁷⁰ Mbrojtësi i Viktimave mund të paraqesë parashtrime në këtë aspekt, nëse ka, në pajtim

⁶⁶ *Shih* para. 34 më lart. *Në mënyrë të ngjashme*, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 40-41.

⁶⁷ *Në mënyrë të ngjashme*, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 42.

⁶⁸ *Shih* poshtëshënimi 58.

⁶⁹ Kur është e përshtatshme, informacioni në pikat (i)-(iii) mund të përmblihet për grupe dokumentesh. *Në mënyrë të ngjashme*, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 43.

⁷⁰ *Shih* Rregullat 76 dhe 138(1), fjalia e dytë, të Rregullores.

me Vendimin mbi të Drejtat e Viktimave.⁷¹ Përveç nëse urdhërohet ndryshe, dorëzimi i përgjigjeve dhe, nëse është e nevojshme, i kundërpërgjigjeve, bëhet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores.

54. Më pas, Trupi Gjykes do të vendosë, siç përmbledhet në paragrafin 21 më lart, në varësi të rregullave përjashtuese të shtjelluara në paragrafët 23-26 më lart, ose të arsyeve të tjera bindëse për përjashtimin e provave. Si rezultat, përveç nëse e përjashton materialin e përmendur, Trupi Gjykes e konsideron të gjithë materialin e përfshirë në kërkesë, si të disponueshëm për kuvendimet e veta mbi vendimin për fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit, pa marrë vendim për çdo material sipas rregullës 138(1) të Rregullores.⁷²

5. Paraqitja e materialit nëpërmjet dëshmitarit

55. Para së gjithash, Trupi Gjykes informon palët dhe Mbrojtësin e Viktimave se udhëzimet në vijim plotësojnë udhëzimet përkatëse të Trupit Gjykes në lidhje me përdorimin e materialit gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve, të përcaktuara në Vendimin mbi Zhvillimin e Gjykimit.⁷³ Udhëzimet e dhëna në këtë vendim kanë të bëjnë me procedurën për paraqitjen si prova të materialeve (të përzgjedhura), të përdorura gjatë marrjes në pyetje të një dëshmitari, i cili e ka përfunduar dhënien e dëshmisë brenda bllokut përkatës të dëshmimeve, dhe që ende nuk i janë paraqitur Trupit Gjykes.⁷⁴

⁷¹ *Shih* Rregullën 76 të Rregullores; Vendimi mbi të Drejtat e Viktimave, para. 50. *Në mënyrë të ngjashme*, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 44.

⁷² *Në mënyrë të ngjashme*, Vendimi mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave në Çështjen 05, para. 45.

⁷³ Vendimi mbi Zhvillimin e Gjykimit, para. 44-51.

⁷⁴ *Në mënyrë të ngjashme*, KSC-BC-2020-05, F00170, Trupi Gjykes I, *Vendim mbi Zhvillimin e Gjykimit* (Vendimi mbi Zhvillimin e Gjykimit në Çështjen 05), 26 gusht 2021, publik, para. 37.

56. Jo më vonë se një javë pas përfundimit të një blloku dëshmish,⁷⁵ ZPS-ja, Mbrojtja dhe Mbrojtësi i Viktimave duhet të dorëzojnë kërkesat e tyre për pranimin e materialeve të përdorura prej tyre gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve, të cilët e kanë përfunduar dhënien e dëshmisë brenda atij blloku. Brenda pesë ditësh nga marrja e kërkesës: (i) pala kundërshtare/palët kundërshtare mund të përgjigjen dhe të paraqesin kundërshtimet e tyre, nëse kanë;⁷⁶ dhe (ii) Mbrojtësi i Viktimave mund të paraqesë parashtrimet e tij, nëse ka, në përputhje me Vendimin mbi të Drejtat e Viktimave.⁷⁷ Përveç nëse urdhërohet ndryshe, dorëzimi i përgjigjeve dhe, nëse është e nevojshme, i kundërpërgjigjeve, bëhet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores.

57. Më pas, Trupi Gjykses do të vijojë, siç përmbledhet në paragrafin 21 më lart, në varësi të rregullave përjashtuese,⁷⁸ ose arsyeve të tjera bindëse për përjashtimin e provave. Si rezultat, përveç nëse e përjashton materialin në fjalë, Trupi Gjykses e konsideron se është në dispozicion për kuvendimet e veta dhe aktgjykimin, pa marrë vendim për çdo material sipas rregullës 138(1) të Rregullores.⁷⁹

58. ZPS-ja, Mbrojtja dhe Mbrojtësi i Viktimave mund të paraqesin nëpërmjet dëshmitarit vetëm materialin që është nxjerrë dhe është përdorur *faktikisht* gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit.⁸⁰

⁷⁵ *Shih* KSC-BC-2020-04, F00405, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Datën e Fillimit të Gjyimit, Paraqitjen e Provave dhe Çështje të lidhura me Të*, 26 janar 2023, publik, para. 15, 18(e), ku caktohen datat për katër blloqet e para të dëshmive; *shih gjithashtu* Vendimin mbi Zhvillimin e Gjyimit, para. 24-26.

⁷⁶ *Shih* Rregullat 9(5), 76 dhe 138(1), fjalia e dytë, të Rregullores.

⁷⁷ *Shih* Rregullën 76 e Rregullores; Vendimi mbi të Drejtat e Viktimave, para. 50. *Në mënyrë të ngjashme*, Vendimi mbi Zhvillimin e Gjyimit në Çështjen 05, para. 37.

⁷⁸ *Shih* para 23-26 më lart.

⁷⁹ *Në mënyrë të ngjashme*, Vendimi mbi Zhvillimin e Gjyimit në Çështjen 05, para. 37.

⁸⁰ *Shih* KSC-BC-2020-05, F00422, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Materialet e Përdorura me Dëshmitarët 200, 300, 400 dhe 500 gjatë Dhënies së Dëshmive të Tyre në Sallën e Gjyqit*, 26 maj 2022, publik, para. 8.

59. Pjesët e deklaratave të mëhershme të dëshmitarëve që *lexohen* dhe diskutohen me dëshmitarët në sallën e gjyqit, bëhen pjesë përbërëse e dëshmisë së tyre.⁸¹ Trupi Gjykses thekson se nuk është e mjaftueshme vetëm përmendja e faqes/faqeve, paragrafit/paragrafëve ose numrit/numrave të rreshtave të deklaratave me shkrim apo transkripteve.

60. Rrjedhimisht, nuk ka nevojë që këto pjesë të deklaratave të mëhershme të paraqiten veças për t'u pranuar si prova; përkundrazi, ato do të jenë pjesë e transkriptit zyrtar të dëshmisë së dëshmitarit në sallën e gjyqit, po aq sa dhe çdo deklaratë tjetër e dëshmitarit e pasqyruar në transkriptin zyrtar. Ato janë automatikisht në dispozicion të Trupit Gjykses për kuvendimet dhe aktgjykimin si pjesë e dëshmisë së dëshmitarëve në sallën e gjyqit. E njëjta gjë vlen edhe për përkthimet dhe incizimet audiovizuale përkatëse të këtyre pjesëve të deklaratave të mëhershme.⁸² Trupi Gjykses thekson se, në përputhje me parimin e paraqitjes së dëshmime gojore, vetëm pjesët e diskutuara me dëshmitarët gjatë dhënies së dëshmime të tyre në sallën e gjyqit janë pjesë e dokumentacionit të provave.⁸³ Kjo për arsyen se provat prej dëshmitarëve janë të papranueshme kur nuk sigurohen gojarisht, ose kur nuk paraqiten sipas rregullave 153-155 të Rregullores.⁸⁴

61. Rrjedhimisht, ZPS-ja, Mbrojtja dhe Mbrojtësi i Viktimave, në dosjet gjyqësore përfundimtare, deklaratën mbi pasojat e veprave penale ose mocionet sipas rregullës 130 të tyre, sipas rastit, duhet t'i referohen dëshmisë së dëshmitarit në sallën e gjyqit ku është diskutuar deklarata e dhënë më parë nga dëshmitari, dhe jo drejtpërdrejt deklaratës së mëparshme. Trupi Gjykses nuk do të marrë parasysh asnjë referencë që

⁸¹ Aktgjykimi *Mustafa*, para. 30.

⁸² Kjo është në përputhje me parimin e përshkruar në paragrafin 42 më lart. Në mënyrë të ngjashme, Vendimi i 17 dhjetorit 2021 në Çështjen 05, para. 14.

⁸³ KSC-BC-2020-05, Transkripti i seancës, 4 tetor 2021, publik, f. 852, rreshti 14 deri në f. 854, rreshti 21.

⁸⁴ *Shih* para. 32, 47 më lart.

bëhet drejtpërdrejt ndaj deklaratave të mëhershme, përveç rasteve kur ato deklarata janë paraqitur sipas rregullave 153-155 të Rregullores.

62. Gjithashtu, gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit, ZPS-ja, Mbrojtja dhe Mbrojtësi i Viktimave, para se ta ballafaqojnë dëshmitarin me një deklaratë të caktuar, duhet gjithmonë të evidentojnë qartë pjesët e deklaratës ose deklaratave të mëhershme të dëshmitarit me të cilat duan ta ballafaqojnë atë, duke përmendur numrin/numrat e regjistrimit të provës (ERN), faqen përkatëse dhe numrat e paragrafëve ose rreshtave përkatës.⁸⁵ Ata duhet të sigurojnë që këto referenca të jenë të sakta dhe të plota. Ata gjithashtu duhet të shmangin perifrazimin e thënieve të dëshmitarit dhe duhet të lexojnë pjesën/pjesët përkatëse të deklaratës së dhënë më parë.

63. Sa u përket materialeve të shënuara nga dëshmitarët në sallën e gjyqit duhet të dorëzohet si versioni original ashtu edhe ai i shënuar nga dëshmitari.

64. Siç theksuam më lart,⁸⁶ palët dhe Mbrojtësi i Viktimave kujdesen që të mos paraqesin materiale që tashmë janë paraqitur me kërkesat e mëparshme dhe/ose janë pranuar ose konsiderohen se janë në dispozicion të Trupit Gjykes për kuvendimet dhe aktgjykimin. Para se të përdorin një material gjatë marrjes në pyetje të një dëshmitari, palët dhe Mbrojtësi i Viktimave duhet të bëjnë të ditur nëse materiali në fjalë është pranuar si provë tashmë ose nëse konsiderohet se është në dispozicion të Trupit Gjykes për kuvendimet dhe aktgjykimin e tij, ose nëse është objekt i një kërkesë të mëparshme.

65. Pas përfundimit të dëshmisë së secilit dëshmitar në sallën e gjyqit, NJAGJ-ja u përcjell përmes postës elektronike ZPS-së, Mbrojtjes, Mbrojtësit të Viktimave dhe Trupit Gjykes një listë të të gjitha materialeve të përdorura gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit përkatës prej tyre. Në listë NJAGJ-ja tregon se cilat materiale janë pranuar

⁸⁵ Shih *gjithashtu* Vendimi mbi Zhvillimin e Gjyimit, para. 50.

⁸⁶ Shih para. 39 më lart.

tashmë, ose konsiderohet se janë në dispozicion të Trupit Gjykses për kuvendimet dhe aktgjykimin e tij, apo janë objekt i kërkesave të mëparshme. Palët dhe Mbrojtësi i Viktimave, nëse dëshirojnë, mund të kundërshtojnë brenda një dite listën e materialeve nga NJAGJ-ja.

6. Lista përmbledhëse e materialeve të pranuar si prova

66. Me qëllimin e dokumentimit të saktë të procesit gjyqsor, në përputhje me nenin 40(5) të Ligjit dhe rregullën 24(1) të Rregullores, brenda dy javësh nga mbyllja e procedurës së paraqitjes së provave në përputhje me rregullën 134 të Rregullores, Zyra Administrative dorëzon për përfshirje në dokumentacionin e çështjes një listë përmbledhëse të të gjitha materialeve të pranuar si prova ose që konsiderohet se janë në dispozicion të Trupit Gjykses për kuvendimet dhe aktgjykimin e tij. Zyra Administrative bën të njohur, sipas rastit, pjesët e secilit material përkatës të përdorur me dëshmitarët gjatë dhënies së dëshmimeve të tyre në këtë çështje.⁸⁷

V. VENDIM

67. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a. **MIRATON** procedurën mbi parashtrimet dhe pranueshmërinë e provave, siç përcaktohet në këtë vendim; dhe
- b. **UDHËZON** palët, Mbrojtësin e Viktimave dhe Zyrën Administrative të respektojnë udhëzimet dhe afatet e përcaktuara më lart.

⁸⁷ Në përputhje me udhëzimin e Trupit Gjykses në paragrafin 59 më lart, në listë nuk do të përfshihen pjesë të deklaratave të mëparshme që janë diskutuar me dëshmitarët në sallën e gjyqit, pasi ato janë pjesë përbërëse e dëshmimeve të dëshmitarëve.

/nëshkrimi/

**Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse**

/nëshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nëshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E premte, 17 mars 2023

Në Hagë, Holandë.